



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	10/03/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Zekrija DUSHI Menaxher i Prokurimit në RTK
CC:	z. Mentor SHALA Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: "Blerja e veprave Audio Vizuale nga producentët e pavarur për RTK-TV1;RTK TV-2; RADIO KOSOVA-1 dhe 2"



I nderuar z. DUSHI,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: "Blerja e veprave Audio Vizuale nga producentët e pavarur për RTK-TV1;RTK TV-2;RADIO KOSOVA-1 dhe 2", me nr. të prokurimit: RTK-13-1000-411, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Blerja e veprave Audio Vizuale nga producentët e pavarur për RTK-TV1;RTK TV-2;RADIO KOSOVA-1 dhe 2", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

Ar sy e t i m

Zyra e Prokurimit në Radio Televizioni e Kosovës – RTK ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Blerja e veprave Audio vizuale nga producentët e pavarur për RTK-TV1;RTK TV-2; RADIO KOSOVA-1 dhe 2”, me nr. të prokurimit: RTK-13-1000-411, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë: 28/11/2013 (Vazhdim Afati), në Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë monitorimit të këtij aktiviteti të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e Prokurimit publik në Kosovë.

Në Dosjen e Tenderit, tek pika 9.1, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar: *Evidenca, përvoja e mëparshme. E obligueshme; * Standardet profesionale dhe kriteret teknike - (kërkohet teknologjia HD). E obligueshme; * Koncepti, përmbajtja e projektit (përshkrimi) E obligueshme. Po ashtu tek Pjesa II. Fleta e të dhënave të tenderit (FDT) Vlerësimi i Koncept Projekteve, pika 23.1, Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve i cili do të përdoret për vlerësimin e Koncept Projekteve janë: Çmimi 20%; Koncepti, përmbajtja e projektit (përshkrimi)50%; Standardet profesionale-kërkohet tek. HD) 30%. Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet prokurimi ka përsëritur Kriteret e përzgjedhjes tek Kriteret e dhënies së Kontratës. Autoriteti duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve për dhënie të kontratës. Sipas ligjeve në fuqi kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kritere për dhënien e Kontratës. Referuar Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, kriteret e dhënies që mund të përdoren për vlerësimin e projekteve konceptuale mund të përfshijnë: inovacionin; përmbajtjen estetike; përshtatjen adekuate me mjedisin përreth; përdorimin efikas të hapësirës ekzistues; dhe tërheqjen për përdoruesit potencial.

Autoriteti Kontraktues nga lot 1 deri në 7 për RTK-TV1 tek fushëveprimi i projektit ka përdorur shprehjet “cikël” si dhe tek sasia nr “1”; Për Lotet 1 deri në 10 për RTK-TV2 tek vëllimi i projektit ka përdorur shprehjet “Sezona” si dhe tek sasia nr “1”; Për Lotet 1 deri në 7 për Radio tek fushëveprimi i projektit ka përdorur shprehjet “cikël” si dhe tek sasia nr “1” ose “2”. Autoriteti Kontraktues me shprehjet “cikël”, “Sezona” si dhe numrat e sasisë që janë përdorur “1” ose “2”, janë shumë të përgjithësuar dhe me këtë rast krijon paqartësi tek Operatorët Ekonomik. Me përdorimin e shprehjeve të tilla, Autoriteti Kontraktues ka lënë hapësirë që Operatorët Ekonomik të interpretojnë kriteret sipas këndvështrimit të tyre, e jo sipas asaj që Autoriteti Kontraktues vërtetë ka nevojë për të realizuar më aktivitetin e prokurimit në fjalë. I vetmi tentim për sqarim në lidhje me shprehjen “cikël” është bërë në faqen 25 të Dosjes së tenderit, ku thuhet: “*Cikël në këtë rast nënkupton një ose me shumë programe me më shumë se një emision” Edhe nga ky tentim sqarim nuk mund të kuptohet asgjë, ngase është shumë e përgjithësuar. Me këtë sqarim, ofertat nga Operatorët Ekonomik mund të mos mbulonin 20% e paraparë, ose mund të shkonin në shumën më të lartë, deri në 100%.

Mos përgatitja e Dosjes së Tenderit në pajtim me Ligjin e Prokurimit ka sjellë deri tek hutimi i Operatorëve Ekonomik. Agjencia Kundër Korrupsion gjatë monitorimit të vlerësimit të tenderit ka vënë re se si pasoj mos qartësisht të modaliteteve të aplikimit, ka ardhur deri tek konfuzioni i Operatorëve Ekonomik. Disa nga Operatorët kanë ofruar çmimin total për një lot, pa cekur numrin e episodeve dhe detajeve sa zgjatë një episode. Të tjerë kanë ofruar numrin e episodeve pa e cekur çmimin për episode, derisa çmimi total iu mungonte. Variante të tilla ka pasur shumë. Të rrallë ishin ata Operator Ekonomik që kishin numrin e episodit, çmimin për episod dhe çmimin total. Por, edhe varianti më perfekt i ofertës determinonte dëshirën e Operatorit Ekonomik për numrin e episodeve, kohëzgjatjen, ciklin, sezonin, etj.

Paqartësi tjetër ishte se Autoriteti Kontraktues për lotet e RTK-TV1;RTK TV-2; RADIO KOSOVA-1 dhe 2, ju ka vënë numrin e lotëve me numër rendor të njëjtë, ky element ka bërë që edhe më shumë të komplikohet përgatitja e ofertave nga Operatorët Ekonomik. Ka pasur raste kur Operatori Ekonomik nuk e ka shënuar nëse ka aplikuar për RTK-TV1, RTK TV-2 ose për RADIO KOSOVA-1 dhe 2 dhe kjo gjendje shpeshherë e ka sjellë në dilemë Komisionin e vlerësimit gjatë punës së tyre.

Në Pjesa II. Fleta e të dhënave të tenderit (FTD), pika 2.1, Qëllimi i Konkursit të Projektimit thuhet: RTK-ja duhet të sigurojë së paku 20 % të programit të prodhuar të RTK-së nga producentët e pavarur, në transmetimet televizive, duke mos i përfshirë këtu programet lajmeve. Konsiderojmë se vlera prej 20% e programit që duhet të sigurohet nga producentët e pavarur është dashur të sqarohet edhe më tej në “njësi”, pastaj ajo të ndahet në “nën njësi” dhe të profilizohet në mënyrë që gjatë aktivitetit të prokurimit, edhe Autoriteti Kontraktues, edhe Operatorët Ekonomik të kenë të qartë se çfarë kërkohet dhe në çfarë ofrohet. P.sh. Nëse kërkohet program edukativ/argëtues, duhet të ceket sa herë në ditë, ditëve të punës ose vikendet, sa është kohëzgjatja e një emisioni dhe sa është totali. Sikur të ishin detajuar modalitetet e gjitha kategorive të veprave Audio vizuale dhe kjo të jetë në përputhje me shumën prej 20% të emetimit të programit në RTK, do të ishte shumë e qartë për Operatorët Ekonomik. Kjo do ta ndihmonte edhe më shumë Autoritetin Kontraktues (RTK-në) që të realizoj objektivat e veta në mënyrë më praktike dhe më transparente.

Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka zbuluar çmimet e ofertave në procesin e hapjes, veprim ky i cili bie ndesh me rregullat për aktivitetit të tilla. Të pranishëm në hapje kanë qenë edhe disa nga Operatorët Ekonomik ofertues.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, Pika 23 Kriteret e Përzgjedhjes dhe pika 51 Konkurs për Projektim, e udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë aktivitetit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për projektuesit ose projektuesit potencial. Pra, të shmanget çdo praktikë që krijon konfuzion tek një projektues i caktuar ose projektues potencial.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !